

SHQIPËRI



THE WORLD BANK

Gatishmëria e Ballkanit Perëndimor për Investime me pjesëmarrje në kapital privat

Mbështetje e NMVM-ve në menaxhimin
financiar për sigurimin e financimit me
pjesëmarrje në kapital privat

21 tetor 2019

Xheko Imperial Hotel Tirana

Rruga Ibrahim Rugova

Nr.56/H2 Tirana AL, 1019

Aktivitet mësimor organizuar nga Banka Botërore në bashkëpunim me
Dhomën Amerikane të Tregtisë, në Shqipëri



EU-REPARIS financohet
nga Bashkimi Evropian dhe
është pjesë e WB EDIF



WB EDIF
Western Balkans
Enterprise Development
and Innovation Facility



Rreth aktivitetit

Ky aktivitet mësimor njëditor ofrohet nga Qendra e Bankës Botërore për Reformën në Raportimin Financiar, në kuadër të projektit për Fuqizimin e Raportimit Financiar dhe Informacionit për NMVM-të në Ballkanin Perëndimor, financuar nga BE-ja në kuadër të iniciativës REPARIS (Rruga drejt Evropës-Programi i Reformës së Kontabilitetit dhe Forcimit Institucional). Aktiviteti do të përsëritet në [Tiranë, Shqipëri; Banja Llukë dhe Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë; Prishtinë, Kosovë; Podgoricë, Mal të Zi; Shkup, Maqedonia e Veriut; dhe në Beograd, Serbi.](#)

Aktiviteti përfshin një diskutim angazhues në panel dhe sesione informuese mësimore për mënyrat se si ofruesit e shërbimeve të drejtimit financiar të

NMVM-ve apo punonjësit e NVMV-ve që merren me drejtimin financiar të mund të mbështesin klientët/punëdhënësit e tyre NMVM për të siguruar investime me pjesëmarrje në pronësi nga kapitali privat.

Ky aktivitet do të pasohet nga trajnime online me bazë modulesh, që do të ofrojnë njohuri më të thella për ata pjesëmarrës që kërkojnë të fitojnë njohuri të mëtejshme në lidhje me tregun e kapitalit privat dhe për mënyrat si mund të përgatisin më mirë klientët e tyre për investime. Më tej, janë përgatitur një seri infografikësh për referencë nga sipërmarrësit/pronarët e NMVM-ve, për të kuptuar procesin e investimeve me pjesëmarrje në kapital.

KAPITALI PRIVAT NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Aktualisht burimi kryesor i kapitalit financiar të disponueshëm për NMVM-të në të gjithë rajonin janë bankat; përmes marrjes së linjave të kredisë, huave bankare dhe formave të tjera të borxhit. Burimet alternative të kapitalit, ose nuk ekzistojnë, ose janë shumë të pakta.

Tregu i kapitalit privat në Ballkanin Perëndimor është në një fazë shumë të hershme zhvillimi dhe

aktualisht mundësia për investime është e kufizuar. Sidoqoftë, kjo mund të ndryshojë me kalimin e kohës, pasi fondet e kapitalit privat kërkojnë t'i zgjerojnë portofolat dhe shtrirjen e tyre gjeografike, prandaj është e rëndësishme që NMVM-të që kërkojnë partnerë kapitali, të jenë në gjendje t'i shfrytëzojnë ofruesit e shërbimeve që të mund të përgatiten në mënyrë të duhur për investime.

KUSH DUHET TË MARRË PJESË?

Ky aktivitet mësimor dhe modulet online janë krijuar posaçërisht për pjesëmarrësit e mëposhtëm:

- Kontabilistë profesionistë* dhe auditues që punojnë në zyra të vogla dhe të mesme kontabël në shërbim të klientëve NMVM,
- Kontabilistë profesionistë dhe punonjës të tjerë të punësuar në sektorin e financës në NMVM,
- Kontabilistë të tjerë, konsulentë financiarë dhe këshilltarë biznesi në shërbim të klientëve NMVM.

Edhe profesionistë të tjerë mund të përfitojnë nga pjesëmarrja në forum, duke përfshirë: *Entrepreneurs wanting to develop awareness of the private equity market and the key areas that need to be considered in becoming investment ready*

- Sipërmarrësit që dëshirojnë të ndërgjegjësohen më shumë në lidhje me tregun e kapitalit, privat dhe fushat kryesore që duhet të kenë parasysh për t'u përgatitur për investime,
- Investitorë të rinj mbështetës me kapital, që mund të duan të krijojnë një ide më të mirë rreth procesit të strukturuar të investimeve për mbështetjen e investimeve të tyre,
- Këshilltarë dhe mentorë në Inkubatorë dhe organizata që ndihmojnë bizneset e reja (Akseleratorë).

* Kontabilistë profesionistë janë kontabilistët e kualifikuar që janë anëtarë të një organi profesional të anëtarësuar në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve

PSE DUHET TË MERRNI PJESË?

Ky aktivitet mësimor (së bashku me modulet online që përmenden më poshtë) ju ofron një mundësi të shkëlqyer për të marrë njohuri mbi mënyrën e funksionimit të tregut të kapitalit privat dhe si mund t'u ndihmoni klientëve/punëdhënësve tuaj të bëhen gati për investime.

- Të kuptoni si funksionon kapitali privat dhe nëse mund të jetë i përshtatshëm për klientët/punëdhënësit tuaj,
- Të kuptoni procesin përmes të cilit fillimisht merret në konsideratë një investim me pjesëmarrje në kapital privat dhe më pas kryet transaksioni dhe

të gjeni pozicionin tuaj për ta mbështetur klientin/punëdhënësin që të bëhet gati për investime,

- Nëse jeni një investitor i mundshëm: të kuptoni proceset e kapitalit me pjesëmarrje për kryerjen e kontrollit dhe strukturimin e investimeve, që mund të jenë të dobishme për ju,
- Nëse jeni sipërmarrës: të kuptoni si funksionon tregu i kapitalit privat, në mënyrë që të kuptoni nëse mund të jetë një burim i vlefshëm kapitali për biznesin tuaj, dhe çfarë lloj mbështetje profesionale kërkohet për të realizuar procesin.

TRAJNIMI VIJUES ONLINE:

Ky aktivitet njëditor ka për qëllim t'u prezantojë kapitalin privat ofruesve të shërbimeve të NMVM-ve dhe të kontribuojë për rritjen e kapaciteteve të tyre për të ndihmuar shoqëritë tregtare NVMV në fazë rritjeje dhe ato në fazë të konsoliduar të sigurojnë kapitalin financiar të nevojshëm për të financuar rritjen dhe zgjerimin e tyre, duke i ndihmuar të bëhen të gatshme për investime.

Për ta mbështetur këtë aktivitet mësimor njëditor, në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve do të vihet një kurs që mund të ndiqet online sipas mundësive të secilit, me ftesën për t'u regjistruar dhe për ta përfunduar këtë trajnim online pa pagesë. Kursi online do të strukturoret si më poshtë:

PREZANTIMI I KURSIT:

- **Moduli 1:** Investimi me pjesëmarrje në kapital dhe kapitali privat
- **Moduli 2:** Përdorimi i fondeve
- **Moduli 3:** Ngjallja e interesit të investitorit
- **Moduli 4:** Negocimi i investimeve me pjesëmarrje në kapital privat
- **Moduli 5:** Pasqyrat financiare dhe analiza financiare
- **Moduli 6:** Vlerësimi i shoqërisë
- **Moduli 7:** Verifikimi i kapitalit privat
- **Moduli 8:** Struktura e marrëveshjes
- **Moduli 9:** Fleta e kushteve
- **Moduli 10:** Drejtimi i brendshëm dhe administrimi pas investimit

Agjenda

Gatishmëria e Ballkanit Perëndimor për Investime me Kapital Privat

9:15 - 10:00

REGJISTRIM I PJESËMARRËSVE

10:00 - 10:15

FJALËT E MIRËSEARDHJE

- Dhoma amerikane e Tregtisë në Shqipëri
- Delegacioni i BE-së
- Banka Botërore

10:15 - 11:00

PREZANTIMI

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Pjesa 1: Prezantimi i programit të ditës, kursit online dhe udhëzuesit infografik për sipërmarrësit e NMVM-ve. Çfarë është gatishmëria për investime dhe cili është roli juaj?

Pjesa 2: Përmbledhje e temave kryesore të kursit online, duke përfshirë mënyrën si funksionojnë fondet e kapitalit privat dhe si të angazhohesh me to, qasja e tyre ndaj strukturimit të marrëveshjeve, dhe drejtimi i brendshëm i firmave të investimit në kapital.

OBJEKTIVAT

- Prezantimi i sektorit të kapitalit privat dhe aktorëve të tij,
- Identifikimi i aspekteve të gatishmërisë për investime,
- Identifikimi i rolit të menaxhimit financiar në gatishmërinë e kapitalit privat për investime, dhe mënyrat si pjesëmarrësit mund t'i mbështesin klientët e tyre,
- Prezantimi i kursit online,
- Paraqitja e udhëzuesve infografikë të përgatitur për sipërmarrësit.

Folës: **John Hodge**, *Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Qendra për Reformën e Raportimit Financiar, Banka Botërore*
Gavin Ryan, *Konsulent i Bankës Botërore*

11:00 - 11:30

PUSHIM KAFEJE

11:30 - 13:00

INVESTIMET E KAPITALIT PRIVAT: PASQYRA E TREGUT, STRUKTURIMI I MARRËVESHJES, VLERËSIMI DHE KUJDESI I DUHUR

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Përmbledhje e tregut të kapitalit privat dhe e mënyrave si i identifikojnë investimet menaxherët e fondeve të tyre. Kuptimi dhe shikimi i përfitimeve të kryerjes së verifikimit të duhur.

Përmbledhje e mënyrës si i vlerësojnë shoqëritë investitorët e kapitalit privat, dhe cilët janë faktorët kryesorë që ndikojnë në mënyrën e strukturimit dhe negociimit të marrëveshjeve të kapitalit privat.

OBJEKTIVAT

- Të krijohet një ide e përgjithshme mbi mënyrën e funksionimit të kapitalit privat,
- Të kuptohen çështjet kyç në strukturimin e marrëveshjeve të kapitalit privat,
- Të kuptohen ndryshimet midis llojeve të kapitalit privat dhe çfarë mund të bëhet për ta rritur vlerën e shoqërisë suaj para marrëveshjes,
- Të kuptohet procesi i verifikimit të duhur: verifikimi nga ana e shitësit dhe nga ana e blerësit.

Trajner: **Gavin Ryan**

13:00 - 14:00

DREKË PUNE PËR VENDOSJE KONTAKTESH

14:00 - 15:30

KOMUNIKIMI DHE NEGOCIIMI I 'INVESTUESHMËRISË' SË BIZNESIT TË NJË KLIENTI

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Krijimi që në fillim i një përshtypjeje të mirë për shoqërinë është thelbësore për ta veçuar atë nga turma. Aftësitë komunikuese janë një element i rëndësishëm për të pasur

sukses. Qasja ndaj negociatave varet nga stili personal, faktorët kulturorë dhe nga qasja specifike ndaj kapitalit privat që duhet pasur parasysh.

OBJEKTIVAT

- Të mësoni si të vini në dukje mundësitë e investimeve në shoqërinë tuaj dhe si të prezantoni një përmbledhje bindëse për të investuar në të,
- Të krijoni një ide të përgjithshme rreth praktikave më të mira në negociata,
- Të identifikoni stilin tuaj personal dhe aspektet kulturore në negociata përmes ushtrimeve në grup.

Trajnerë: **John Hodge**, *Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Qendra për Reformën e Raportimit Financiar, Banka Botërore*
Gavin Ryan, *Konsulent i Bankës Botërore*

15:30 - 15:45

PUSHIM KAFEJE

15:45 - 17:15

DISKUTIM NË PANEL: BËRJA GATI PËR SIGURIMIN E FINANCIMEVE ME KAPITAL

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Anëtarë të shquar të komuniteteve rajonale dhe kombëtare të investitorëve do të diskutojnë opsionet e NMVM-ve për të

siguruar financime jo nëpërmjet borxhit, dhe atë çka ato duhet të kenë parasysh për të pasur sukses në sigurimin e financimeve të tilla.

OBJEKTIVAT

- Të identifikohen burimet aktuale të financimeve dhe burimet e ardhshme të mundshme,
- Të përfitohen njohuri nga panelistët mbi çka është e rëndësishme për suksesin e një NMVM-je që kërkon financim kapitali.

TEMAT QË DO TË DISKUTOHEN

- Opsionet aktuale të disponueshme për sigurimin e financimeve jo përmes borxhit,
- Burimet e mundshme të financimit të kapitalit në planin afatmesëm deri në afatgjatë, dhe investimet e pritshme,
- Histori suksesi në rajon/vend,
- Çfarë është e rëndësishme, nga këndvështrimi i menaxhimit financiar, në përgatitjet për të kërkuar financim me pjesëmarrje në kapital privat,
- Situata e tanishme në lidhje me drejtimin e brendshëm të shoqërive dhe transparencën financiare, dhe si mund të ndikojë kjo në klimën e investimeve.

Moderatorë: **John Hodge**, *Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Qendra për Reformën e Raportimit Financiar, Banka Botërore*
Gavin Ryan, *Konsulent i Bankës Botërore*

17:15 - 17:30

Mbyllja